



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi



RAPORT PERIODIK

2025

JANAR - QERSHOR

I NJAB-së PËR AUDITIMIET E PËRFUNDUARA DHE
AKTIVITETET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Korrik, 2025

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Llogaridhënia menaxheriale	3
3. Planifikimi i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm.....	3
4. Rezultatet kryesore për periudhën janar-qershor 2025.....	4
5. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve	4
6. Bashkëpunimi me Komitetin e Auditimit.....	4
7. Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) – Auditorin e Jashtëm.....	5
8. Detyrat e Shërbimit Këshillues dhe aktivitetet tjera të NJAB-së.....	5

1. Hyrje

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në strukturën organizative të Komunës funksionon brenda Zyrës së Kryetarit të Komunës. NJAB përbëhet nga Udhëheqësi dhe një auditor. Sipas Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, NJAB vepron në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt Udhëheqësit të subjektit publik, duke njoftuar Komitetin e Auditimit. Njësia ka pavarësi funksionale në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e auditimeve. Ky funksion operon në harmoni me Udhëzimin Administrativ MF-NR.01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e sektorit publik.

2. Llogaridhënia menaxheriale

- Udhëheqësja e NJAB-së i raporton Kryetarit të Komunës dhe Departamentit Qendror Harmonizues në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve (DQH/AB-MFPT) përmes raporteve gjashtëmujore dhe raportit vjetor.
- Për secilin raport individual, NJAB i raporton Kryetarit të Komunës dhe ia dorëzon një kopje drejtorit të drejtorisë përkatëse.
- Komiteti i Auditimit (KA) është njoftuar në kohë për auditimet e përfunduara dhe aktivitetet e NJAB.
- Raporti gjashtëmujor i NJAB për vitin 2025 është miratuar nga Kryetari i Komunës, është dorëzuar DQH/AB-MFPT dhe është shqyrtuar nga KA.

3. Planifikimi i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm

- Në përputhje me Nenin 25 pika 3.3 të Ligjit Nr.06/L-021, Udhëheqësi i NJAB-së ka përgatitur dhe dorëzuar Planin Strategjik dhe Planin Vjetor për vitin 2025 për miratim në kohë (dhjetor 2024).
- Planin Vjetor përfshinte 6 detyra audituese, të bazuara në vlerësimin e rrezikut sipas shkallës së lartë, mesme dhe të ulët të rrezikshmërisë.
- Menaxhimi i kohës përfshin aktivitetet auditues, punë administrative, trajnime, si dhe përgatitjen e planeve strategjike dhe vjetore.
- Procesi i auditimit përbëhet nga 4 faza: planifikim, terren, raportim dhe përcjellje.
- Entiteti i audituar ka për detyrë të hartojë Planin e Veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve. NJAB përgatit orarin e përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve.

Objektivat kryesore për vitin 2025:

1. Rishikimi periodik i zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme;
2. Kryerja e 6 detyrave audituese sipas planit vjetor;
3. Raportimi periodik për Kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe NJQHAB/MFPT;
4. Bashkërendimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe mbajtja e 4 takimeve me Komitetin e Auditimit.

4. Rezultatet kryesore për periudhën janar-qershor 2025

- Janë finalizuar 3 raporte auditimi dhe 2 raport për rishikimin e rekomandimeve.
- Detyrat audituese të përfunduara:
 1. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2024(1 rekomandim) dhe raporti i rishikimi i zbatimit të rekomandimeve për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025
 2. Procesi i subvencioneve dhe transfereve (4 rekomandime);
 3. Procesi i planifikimit dhe inkasimit të të hyrave nga taksat komunale (1 rekomandim);
 4. Auditimi i performancës për menaxhimin dhe ruajtjen e pasurisë jo-financiare (5 rekomandime).
- Përveç detyrave të shërbimit të sigurisë (DSHS), janë ofruar edhe shërbime këshillimore për Kryetarin, drejtorët dhe zyrtarët komunal.
- DSHS mbetet një aktivitet i vazhdueshëm i NJAB-së.

5. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve

- Gjatë periudhës janar-qershor 2025 janë verifikuar 18 rekomandime (10 të vitit 2025 dhe 8 të vitit 2024).
- Nga to:
 - 7 (38.8%) janë zbatuar plotësisht;
 - 3 (16.66%) janë në proces zbatimi;
 - 8 (44.44%) janë të pazbatuara.

6. Bashkëpunimi me Komitetin e Auditimit

- Në përputhje me Udhëzimin Administrativ MF-NR.01/2019, NJAB ofron shërbimet e sekretarisë për Komitetin e Auditimit.
- Janë përgatitur dhe dorëzuar të gjitha materialet e nevojshme për takimet e KA gjatë periudhës raportuese.
- Mbajtja e dy takimeve me Komitetin e Auditimit gjatë periudhës raportuese.

7. Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) – Auditorin e Jashtëm

- NJAB ka dorëzuar kopjet e raporteve të auditimeve të kryera për vitin 2025 ekipit të ZKA-së